



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 71, datë 21.08.2020

PËR

**PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË PARAQITUR NGA
SUBJEKTI PERSON FIZIK KRENAR GOGA, KUNDËR VENDIMIT NR. 4 DATË
21.07.2020 VENDOSUR NDAJ SUBJEKTIT OSHMA "TV ME KABËLL ERDEN".**

Autoriteti i Mediave Audiovizive
I përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar

Mori në shqyrtim çështjen me:

- Ankues: Subjekti person fizik Kenar Goga
Objekt: Kundërshtim i vendimit për dënimin me gjobë të vendosur ndaj subjektit OSHMA "Tv me kabëll Erden", me nr. 4, datë 21.07.2020.
Baza Ligjore: Ligji nr. 97/2013 Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv. Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 10 279, datë 20.05.2019 "Për kundravajtjen Administrative".

Në datën 15.07.2020, grupi i inspektimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas urdhrorit të Kryetarit të AMA-s, nr. 115 datë 13.07.2020 "Për inspektimin e veprimtarisë së subjekteve (OSHMA), inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarive të pa licencuara/paautorizuara", u paraqit në adresën ku janë të

instaluarë pajisjet audiovizive transmetuese të subjektit person fizik z. Krenar Goga autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Erden" në njësinë administrative Roskovec.

Në bazë të rregullores "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe ose/audioviziv", inspektimi u krye në prezencë përfaqësuesit të subjektit z. Arbëri Xhaxhaj dhe programet (kanalet) që ishin në transmetim gjatë inspektimit u mbajtën në procesverbalin e konstatimit të programeve dhe, më konkretisht, programet (kanalet) si më poshtë:

- | | | |
|-------------------|---------------------|----------------------|
| 1. Info Kabllor | 38. Rai 2 | 77. Tring Fantasy |
| 2. Rtsh 1 | 39. Rai 3 | 78. Tring Action |
| 3. Top Channel | 40. Rtsh Shqip | 79. Tring Super |
| 4. Klan Tv | 41. Rtsh + | (Hd) |
| 5. Vizion + | 42. Rtsh 24 | 80. Jolly Hd |
| 6. Abc News | 43. Living Hd | 81. T (Hd) |
| 7. Ora News | 44. Tring Comedy | 82. Tring Shqip |
| 8. News 24 | 45. Dmax | 83. Tring Sport |
| 9. Report Tv | 46. Rai Storia | News |
| 10. A2 Cnn | 47. Rai Scuola | 84. Tring Sport 1 |
| 11. Fax News | 48. Rai Gulp | 85. Tring Sport 2 |
| 12. Utv | 49. Euronews Italia | 86. Tring Sport 3 |
| 13. Euronews | 50. Euronews Greek | 87. Super Sport 1 |
| Albania | 51. Estv (Black) | 88. Super Sport 3 |
| 14. Top News | 52. Edessa Tv | 89. Super Sport 4 |
| 15. Tring 7 News | 53. Rt Tv (Hd) | 90. Rtsh Sport |
| 16. Scan Tv | 54. Rtl | 91. Explorer Natyra |
| 17. Apollon Tv | 55. Rt Doc Tv | 92. Italian Fashion |
| 18. In Tv | 56. Telepace Hd | 93. Explorer Histori |
| 19. Rtv Ora | 57. Melody Tv | 94. Rai Sport |
| 20. Folk+ | 58. Line Tv | 95. Tring World |
| 21. My Music | 59. Tring 3+ | 96. Explorer |
| 22. Bbf (Black) | 60. Tdc | Shkencë |
| 23. Tip Tv | 61. Alsat (M) | 97. Rtsh 3 |
| 24. Tring Tring | 62. Klan Plus | 98. Supertenis (Hd) |
| 25. Nickleodeon | 63. Elrodi Tv | 99. Eurosport 1 |
| 26. Klan Kosova | 64. Stv Folk | 100. Sports Tv |
| (Black) | 65. Rtsh Muzikw | 101. Desire |
| 27. Smile | 66. Fen Folk Tv | 102. Das Erste |
| 28. Rtv 21 | 67. Planeta Folk | 103. Bunga Bunga |
| 29. Rtk 1 (Black) | 68. Folkor Tv | 104. Zdf |
| 30. Tring Planet | 69. Balkanika | 105. Italia 1 |
| 31. Tring History | 70. Fen Tv | 106. Canale 5 |
| 32. Film Aksion | 71. Deluxe Music | 107. Alpha |
| 33. Tring Life | 72. Tring Kids | 108. Ant 1 |
| 34. Stinët | 73. Bang Bang | 109. Open Beyond |
| 35. Family Hd | 74. Junior Tv | 110. Super Rtl |
| 36. Rai News 24 | 75. Film Hits | 111. Rtl 2 |
| 37. Rai 1 | 76. Film Njw | 112. Vox |

113.Meltem Tv
114.Kadirga Tv

115.Guney Tv
116.Dyar Tv

117.Cay Tv
118.Knal D Drama

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në AMA konstatohet se subjekti, nuk disponon asnjë kontratë për të drejtën e transmetimit të programeve (kanaleve) si më poshtë:

- | | | |
|---------------------|------------------|-------------------|
| 1. Rai 1 | 15. Rtl | 30. Das Erste |
| 2. Rai 2 | 16. Rt Doc | 31. Zdf |
| 3. Rai 3 | 17. Telepace Hd | 32. Italia 1 |
| 4. Rtsh Shqip | 18. Melody Tv | 33. Canale 5 |
| 5. Rtsh + | 19. Line Tv | 34. Alpha |
| 6. Rtsh 24 | 20. Rtsh Muzikw | 35. Ant 1 |
| 7. Dmax | 21. Fen Folk Tv | 36. Open Beyond |
| 8. Rai Storia | 22. Planeta Folk | 37. Super Rtl |
| 9. Rai Scuola | 23. Balkanika | 38. Vox |
| 10. Rai Gulp | 24. Fen Tv | 39. Meltem Tv |
| 11. Euronews Italia | 25. Deluxe Music | 40. Kadirga Tv |
| 12. Euronews Greek | 26. Rai Sport | 41. Guney Tv |
| 13. Edessa Tv | 27. Rtsh 3 | 42. Dyar Tv |
| 14. Rt Tv | 28. Supertennis | 43. Kanal D Drama |
| | 29. Sports Tv | |

Në lidhje me **kanalin (programin) "Info Kabllor"**, AMA nuk ka dhënë asnjë autorizim, për rrjedhojë, dalja në transmetim e këtij kanali, pa autorizimin e AMA-s, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që rregullon fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Nga gjithë sa më sipër, konkludohet se subjekti person fizik z. Krenar Goga, i autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Erden", në çastin e ushtrimit të kontrollit, është konstatuar duke përsëritur programe (kanale) të të tretëve, për të cilat nuk ka nënshkruar kontrata/marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre programeve, fakt ky që vjen në kundërshtim me nenin 32/6, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit: "**OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave.**"

Në këto kushte, ndaj subjektit në fjalë është proceduar me Vendimin nr. 4 datë 21.07.2020, duke e dënuar me gjobë atë në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

Kundër këtij vendimi, me shkresën nr. 2012/1 prot. datë 03.08.2020, subjekti ka paraqitur ankim administrativ, ndër të tjera duke pretenduar se:

- *Për këto kanale ne i informuam inspektorët që kemi lidur një kontratë marrëveshje me shoqatën e kabllorëve RRTL që prej fillimit të muajit korrik por për arsye objektive nuk kemi pasur mundësi ta firmosim të dyja paltë dhe për këtë arsye nuk ishte depozituar akoma në AMA deri në momentin e kryerjes së kontrollit. Për këtë kontratë detyrimet financiare me shoqatën kanë filluar që në fillim të muajit korrik, gjë të cilën mund të vërtetoni lehtësisht duke ju drejtuar atyre. Për dijeni të kësaj marrëveshje ka qënë dhe AMA, sepse kompania që zotëron të drejtat e shpërndarjes së EBU-së për vendin tonë, ka vendosur cc në email edhe ju si autoritet. Theksojmë se nga ana teknike për marrjen e këtyre kanaleve akoma nuk është gjetur një*

zgjedhje përfundimtare me subjektin që disponon këto të drejta për shqipërinë. Aktualisht ato ne i marrim nëpërmjet frekuencës satelitore Hobart dhe si e tillë përveç kanaleve që ne disponojmë në kontratë, mund të listohen dhe disa kanale të tjera që ne nuk i kemi. Një gjë e tillë ndodh gjithmonë në periudhë testimi deri në gjetjen e një mënyre për të eliminuar këtë problematikë.

Pas njohjes me pretendimet e palës ankuese, bëjmë me dije, se me shkresën nr. 2193 prot., datë 12.08.2020 ka depozituar pranë AMA-s, autorizim me "Shoqatën e transmetuesve Radioteleviziv kabllorë-valorë", shoqatë e cila gëzon të drejtat e shpërndarjes së kanaleve (programeve) EBU në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra, me këtë autorizim subjekti justifikon transemtimin e kanaleve (programeve) për të cilat është sanksionuar me vendim për dënim me gjobë. Gjithashtu subjekti në fjalë ka qenë i rregullt në respektimin e detyrimeve ligjore dhe është hera e parë që kryen një kundravajtje administrative, pra nuk është sanksionuar më parë nga AMA.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 133, pika 11 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", si dhe rregullores "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv", miratuar me Vendimin nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s, Autoriteti i Mediave Audiovizive.

VENDOSI:

1. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e vendimit nr. 4 datë 21.07.2020 për dënimin me gjobë, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, të subjektit person fizik Krenar Goga, për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Erden".
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", duke filluar nga dita e marrjes dijeni.
3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian

SALA

Zëvendëskryetar: Sami

NEZAJ

Anëtarë: Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

Agron

GJEKMARKAJ